

## 32004R0363

Rregullore e Komisionit (KE) nr.363/2004, datë 25 shkurt 2004, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 68/2001, mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën e trajnimit

*Gazeta Zyrtare L 063, 28/02/2004, fq. 0020 – 0021*

Rregullore e Komisionit (KE) nr.363/2004, datë 25 shkurt 2004, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 68/2001, mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën e trajnimit

### KOMISIONI I KOMUNITETIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 994/98, datë 7 maj 1998, mbi zbatimin e neneve 92 dhe 93 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian, për disa kategori të ndihmës shtetërore horizontale dhe, në veçanti, neni 1 pika 1 germa (a) nënpika (iv) e tij,

Pasi publikoi një projekt të kësaj rregulloreje,

Pasi u konsultua me Komitetin Këshillimor për Ndihmën Shtetërore,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 68/2001 parashikon kushte të veçanta për ndihmën e dhënë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Rregulloren (KE) nr. 68/2001 është ai që përdoret në Rekomandimin e Komisionit 96/280/KE, datë 3 prill 1996, “për përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”. Ky rekomandim është zëvendësuar nga Rekomandimi 2003/361/KE, datë 6 maj 2003, “për përkufizimin e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, me efekt nga 1 janari 2005. Për shkak të sigurisë ligjore, përkufizimi i përdorur në Rregulloren (KE) nr. 68/ 2001 duhet të jetë i njëjtë me atë të përdorur në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 70/2001, datë 12 janar 2001, për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- (2) Përvoja ka treguar se është e nevojshme pasja e një sistemi të njësuar dhe të thjeshtë të raporteve vjetore, të miratuara sipas nenit 27 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 659/1999, datë 22 mars 1999, e cila përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të BE-së. Prandaj, dispozitat e veçanta të mënyrës së raportimit, të dhëna në Shtojcën III të Rregullores (KE) nr. 68/2001, zbatohen vetëm për aq kohë, sa të krijohet një sistem i përgjithshëm i raportimit.
- (3) Është e nevojshme të parashikohen dispozita për vlerësimin e përputhshmërisë me tregun e përbashkët të çdo ndihme për trajnim, të dhënë pa një miratim paraprak të Komisionit përpara hyrjes në fuqi të Rregullores (KE) nr. 68/2001.
- (4) Në këto kushte, Rregullorja (KE) nr. 68/2001 duhet ndryshuar,

### KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Rregullorja (KE) nr. 68/2001 ndryshohet si vijon:

1. Neni 1 zëvendësohet si më poshtë:

"Neni 1  
**Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për ndihmën e trajnimit në të gjithë sektorët, përfshirë veprimtaritë që lidhen me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të listuar në Shtojcën I të Traktatit, me përjashtim të ndihmës që bie në fushën e zbatimit të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1407/2002.

2. Në nenin 2 pikat (b) dhe (c) zëvendësohen si më poshtë:

- (b) "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" janë ndërmarrjet siç janë përcaktuar në Shtojcën I të Rregullores së Komisionit (KE) nr. 70/2001;
- (c) "ndërmarrje të mëdha" janë ndërmarrjet që nuk bien në përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

3. Në nenin 7, paragrafi 3 zëvendësohet si më poshtë:

"3. Shtetet Anëtare hartojnë një raport vjetor për zbatimin e kësaj rregulloreje në përputhje me dispozitat zbatuese në lidhje me formën dhe përmbajtjen e raporteve vjetore, të cilat janë dhënë në nenin 27 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 659/1999. Deri në momentin kur këto dispozita të hyjnë në fuqi, Shtetet Anëtare hartojnë një raport vjetor për zbatimin e kësaj rregulloreje për çdo vit kalendarik ose për çdo pjesë të vitit kalendarik, për të cilin gjen zbatim kjo rregullore, në formën e dhënë në Shtojcën III, si dhe në formë elektronike. Shtetet Anëtare e dorëzojnë raportin pranë Komisionit jo më vonë se tre muaj pas mbarimit të periudhës që mbulohet nga raporti".

4. Neni 7a shtohet si më poshtë:

"Neni 7a  
**Dispozita kalimtare**

Skemat e ndihmës, të vëna në zbatim përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe ndihma e dhënë sipas këtyre skemave, në mungesë të miratimit të Komisionit dhe në kundërshtim me kërkesën për njoftim sipas nenit 88 pika 3 të Traktatit, duhet të jenë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe përjashtohen, nëse përmbushin të gjitha kushtet e dhëna në nenin 3 pika 2 germa (a) dhe nenin 3 pika 3 të kësaj rregulloreje. Ndhima individuale jashtë çdo skeme, e dhënë para datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pa një miratim të Komisionit dhe në kundërshtim me kërkesën për njoftim të nenit 88 pika 3 të Traktatit, është në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe është e përjashtuar, nëse ajo përmbush të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje, me përjashtim të kërkesës së nenit 3 pika 1 që shpreh referencën që bëhet në rregullore. Çdo ndihmë, që nuk përmbush këto kushte, vlerësohet nga Komisioni në bazë të kuadrit ligjor, orientimeve, komunikatave dhe njoftimeve përkatëse.

5. Shtojca I shfuqizohet.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi njëzet ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European.

Kjo rregullore është detyruese dhe drejtpërdrejtë e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare. Nënshkruar në Bruksel, më 25 shkurt 2004.

Për Komisionin

Mario Monti

Anëtar i Komisionit

[1] GZ L 142, 14.05.1998, fq. 1.

[2] GZ C 190, 12.08.2003, fq. 2.

[3] GZ L 10, 13.01.2001, fq. 20.

[4] GZ L 107, 30.04.1996, fq. 4.

[5] GZ L 124, 20.05.2003, fq. 36.

[6] GZ L 10, 13.01.2001, fq. 33.

[7] GZ L 83, 27.03.1999, fq. 1, rregullore e ndryshuar nga Akti i Aderimit i vitit 2003.

[8] GZ L 205, 02.08.2002, fq. 1.

[9] GZ L 10, 13.01.2002, fq. 33.

[10] GZ L 83, 27.03.1999, fq.1.